

**Njoftim për ndërmarrjen e përbashkët të LG Elektroniks Ink, Koreja dhe SM Entertejment Ko. Ltd. Koreja**

**(lënda nr. 08-31/2022)**

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë "nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më datë 27.01.2022, Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës i është dorëzuar njoftim për përqendrim, i cili i referohet krijimit të ndërmarrjes së përbashkët nga LG Elektroniks Ink. (LG Electronics Inc.) me seli të regjistruar në 128, Jeoui-daero, Jeongdeungpo-gu, Seul, Republika e Koresë dhe SM Entertejment Ko. Ltd. (SM Entertainment Co. Ltd.), me seli të regjistruar në 89-21, Vangsimni-ro, Seongsimni-gu, Seul, Republika e Koresë.

**Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktiviteti i tyre i biznesit :**

**LG Elektroniks Ink** është një prodhues dhe furnizues global i elektronikës, pajisjeve të komunikimit celular dhe pajisjeve shtëpiake, në nivel botëror me rreth 76,000 punonjës në 142 vende në mbarë botën. Të ardhurat botërore të LG Elektroniks Inc., në vitin 2020, ishin 47,4 USD miliarda. LG Elektroniks Ink i zhvillon aktivitetet e saj nëpërmjet katër njësive të biznesit: Home Entertainment; (HE), Business Solutions; (BS), Home Appliance & Air Solutions; H&A dhe Vehicle Components; VC.

LGE nuk është drejtpërdrejt e pranishme në Maqedoninë e Veriut, por ka realizuar të ardhura nga shitjet indirekte në Maqedoninë e Veriut.

**SM Entertejment Ko. Ltd.** është një shoqëri aziatike udhëheqëse për argëtim , e themeluar në 1995 me rreth 1700 punonjës në mbarë botën. Në 1997, ajo u bë kompania e parë në industrinë koreane të argëtimit që hyri në tregjet e huaja. SM Entertejment Ko. Ltd. ka hyrë me sukses në Amerikën e Veriut, Amerikën e Jugut dhe Evropën, duke ruajtur ende bazën e saj në Azi, dhe ka përmirësuar markën kombëtare të Koresë dhe ka promovuar rritjen e industrisë së kulturës. SM Entertejment Co. Ltd. promovon kulturën unike të Koresë përmes K-POP, alfabetit korean dhe kuzhinës koreane, përmes përmbajtjes "Krijuar nga SM" ("Made by SM") në mbarë botën.

SME nuk ka regjistruar shoqëri të varura në Maqedoninë e Veriut, por ka realizuar të ardhura të papërfillshme në Maqedoninë e Veriut në vitin 2020 dhe 2021 nga shitjet e drejtpërdrejta

*Parashtruesi i njoftimit konsideron se si treg relevant, për qëllimet e vlerësimit të përqendrimit, mund të definohet tregu për aplikimet e shëndetit dhe fitnessit*

*Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.*

*Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email:*

*kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.*

*31.01.2022*

*Shkup*